

VENDIM
Nr. 573, datë 22.7.2020

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE TË SISTEMIT TË KRAHASIMIT
DHE VLERËSIMIT TË SIGURT TË IDENTIFIKIMIT PERSONAL (PISCES) DHE
SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE ME SISTEMIN TOTAL TË MENAXHIMIT
(TIMS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të ligjit nr. 42/2018, “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”, dhe të ligjit nr. 72/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin në Ministrinë e Brendshme të sistemit të krahasimit dhe vlerësimit të sigurt të identifikimit personal (PISCES) dhe të shkëmbimit të bazës së të dhënave të këtij sistemi me sistemin total të menaxhimit të informacionit (TIMS).

2. Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave të sistemit “PISCES” dhe ndëreveprimin e tij me sistemet e tjera të informacionit, nëpërmjet teknologjisë së shërbimit standard *web-service*.

3. Ministria e Brendshme përcakton politikat e sigurisë për administrimin e pajisjeve dhe të dhënave të këtij sistemi.

4. Sistemi “PISCES” ka për qëllim regjistrimin e hyrje–daljeve në Republikën e Shqipërisë të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, në pikat e kalimit kufitar ku ky sistem do të implementohet, si dhe shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit dhe të kalimit të paligjshëm të kufirit.

5. Dhënësi i informacionit për sistemin “PISCES” është Policia e Shtetit.

6. Sistemi i menaxhimit total të informacionit “TIMS” do të ndëreveprojë me sistemin e krahasimit dhe vlerësimit të sigurt të identifikimit personal “PISCES”, si plotësues të njëri-tjetrit, në përputhje me nevojat e Policisë së Shtetit.

7. Importimi i të dhënave historike nga sistemi “TIMS” në sistemin “PISCES” do të bëhet për, të paktën, 5 (pesë) vitet e fundit.

8. Të dhënat që do të importohen nga sistemi “TIMS” në sistemin “PISCES” do të jenë hyrjet dhe daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në pikat e kalimit kufitar, si dhe kategorive INAD/deportiv/refuzuar.

9. Procedurat për funksionimin dhe përdorimin nga Policia e Shtetit të sistemit “PISCES” përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

10. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama